



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ofron bursa duke u bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë nr.04//L-037, prioritetet nacionale dhe interesat strategjike të vendit që synojnë mbështetjen e studentëve të shkëlqyer me bursa në programet e studimit në të gjitha fushat, për studentët me aftësi të kufizuara, në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, për rritjen e kapaciteteve në shkenca teknike, mbështetur në Udhëzimin administrativ nr. 14/2017 të datës 06.12.2017 dhe vendimin e Ministres nr. 01B/314 të dt. 18.10.2021:

SHPALL
KONKURS
PËR NDARJE TË BURSIVE PËR STUDENTËT E UNIVERSITETEVE PUBLIKE NË
PROGRAMET: BAÇELOR DHE MASTER PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022

Kushtet dhe kriteret

1. Për fitimin e bursës së MASHTI, kandidatët duhet ti plotësojnë këto kushte dhe kriteret bazë:
 - 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Të kenë përfunduar vitin e parë në studimet BA dhe vitin e parë për studimet MA;
 - 1.3. Të kenë të përfunduar të gjitha provimet paraprake dhe kreditë e fituara për vit akademik, pa përsëritje të vitit;
 - 1.4. Të drejtë aplikimi kanë studentët e të gjitha fushave të studimit;
 - 1.5. Të gjitha fushat e studimit sipas UA 14/2017, duhet të kenë notën mesatare të studimeve së paku 9.0;
 - 1.6. Studentët duhet të kenë së paku dy referenca të profesorëve.
 - 1.7. Kriteret në pikën nr. 1.2, 1.3, 1.5, 1.6, përjashtohen për studentët me aftësi të kufizuara.

Kategoritë e studentëve me përparësi

2. Kategoritë e kandidatëve që do të kenë përparësi për fitimin e bursës nga MASHTI, në kushte të barabarta me studentët tjerë janë:
 - 2.1. Fëmijët e dëshmorëve të luftës së UÇK-së;
 - 2.2. Invalidët e luftës së UÇK-së dhe fëmijët e tyre;
 - 2.3. Veteranët e luftës së UÇK-së dhe fëmijët e tyre;
 - 2.4. Fëmijët e të zhdukurve të luftës;
 - 2.5. Fëmijët e familjeve që janë përfitues të skemave sociale;
 - 2.6. Fëmijët e ish të dënuarve, të burgosurve dhe të përndjekurve politik;
 - 2.7. Fëmijët të cilët janë më tepër se një student nga një familje;
 - 2.8. Kriteret dhe kushtet për studentët me aftësi të kufizuara, janë sipas udhëzimit nr. 14/2017.

Dokumentacioni që kërkohet për të gjithë studentët

1. Aplikacioni plotësohet online në vegzën <https://ekosova.rks-gov.net/Services/SubService?service=318>.
2. Certifikata e vërtetuar e notave nga fakulteti për dy nivelet e studimit (BA dhe MA), me notë mesatare dhe kreditë e fituara të cekura.
3. Të gjitha dokumentet që kërkohen me UA. 14/2017, duhet të jenë origjinale dhe të lëshuara nga organet kompetente. Të njëjtat duhet skanuar dhe ngarkuar në fushat përkatëse.
4. Dy referenca nga profesorët kompetent.

Kandidatët e kategorive sipas nenit 4 të UA 14/2017, duhet të sjellin të gjithë dokumentacionin si më lartë dhe dëshmi të vlefshme nga organet kompetente.

Procedurat e aplikimit

- Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike në vegzën <https://ekosova.rks-gov.net/Services/SubService?service=318>.

Video informuese rreth procedurave të aplikimit është vegëza <https://ekosova.rks-gov.net/Video/gFtBllmE-lw>

- Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni.
- Pas plotësimit të aplikacionit me sukses, përmes postës elektronike dhe njoftimit automatik në Platformën eKosova aplikuesi/ja pranon konfirmimin.
- Nuk kanë të drejtë aplikimi studentët absolvent dhe studentët me studim 1 vjeçar Master.
- Aplikuesit/et do të pranojnë SMS përmes postës elektronike ku do të njoftohen për rezultatin.
- Lista e studentëve përfitues do të bëhet publike në uebfaqen e MASHTI dhe studentët përfitues do të pranojnë SMS si dhe njoftimin përmes postës elektronike ku do të njoftohen për rezultatin.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë, nga data: 25/10/2021 deri më 08/11/2021, në ora 16:00.

E drejta e ankesës: Kandidatët që kanë aplikuar për përfitim të bursës, kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas shpalljes së rezultateve. Ankesat dorëzohen në arkivin e MASHTI, kati përdhës, zyra nr. 4 dhe shqyrtohen nga komisioni për ankesa dhe parashtrësia i MASHTI.